

INFORMATA MBI GRANTIN

Instrumenti:	Grant Institucional
Subjekti zbatues:	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rr. Hamëz Jashari, 16b/2, Prishtinë info@krct.org +383 (38) 243 707 https://krct.org/
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01/03/2026 Data e përfundimit: 31/12/2028
Buxheti i përgjithshëm i organizatës(EUR):	EUR 2,540,054.50
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	EUR 114,000.00
Grupet e synuara:	Të mbijetuarit e dhunës seksuale të luftës në Kosovë.
Shtrirja gjeografike:	Gjithë Kosovën
Përmbledhje e grantit:	<p>Përmes mbështetjes institucionale, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) synon të vazhdojë misionin e saj afatgjatë për sigurimin e drejtësisë, dinjitetit dhe përfshirjes sociale për të mbijetuarit e torturës dhe të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin në Kosovë.</p> <p>Në përputhje me Strategjinë 2026–2028, QKRMT do të vazhdojë të ofrojë shërbime të integruara rehabilitimi dhe të zhvillojë aktivitete avokimi dhe ndërgjegjësimi publik për të adresuar stigmatizimin dhe për të promovuar një qasje institucionale të informuar mbi traumën. Përmes përfshirjes aktive të të mbijetuarve në hartimin e programeve, monitorim dhe avokim, si dhe përmes punës me komunitete në të gjithë vendin, organizata synon të forcojë shërimin, drejtësinë dhe përfshirjen sociale.</p>

Bashkëfinancuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Suedia
Sverige



	<p>Përmes kësaj mbështetjeje institucionale, QKRMT synon të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve dhe të konsolidojë rolin e saj si një organizatë kyçe në promovimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe pajtimit afatgjatë në Kosovë.</p>
--	---